


AFËRSISHT, GJYSMA E ZJARREVE NË PYLL JANË TË SHKAKTUARA NGA FAKTORI NJERZOR, SIÇ JANË



SI TË PËRGATITENI



Përgatitni ose blini set për

NDIHMËN E SHPEJTË



Mësoni më shumë për

MBROJTJEN KUNDËR ZJARRIT



Përgatitni plan për

EVAKUIMIN



Bëjeni shtëpinë rezistente nga

ZJARRET

MOS HARRONI


Se ç'farë duhet të bëni në rast se ndizen rrobat tuja



NDALONI!



SHTRIHUNI NË TOKË!



RROKULLISUNI NË TOKË

KOORDINATOR I PROJEKTIT:
Organi shtetëror i mbrojtjes dhe shpëtimit



PARTNERËT E PROJEKTIT:



Drejtoria e emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Malit të Zi



PJESMARRËS NË PROJEKT / PJESMARRËS NË LOJË:



I KOOFINANCUAR NGA
MEKANIZMAT E EB
PËR MBROJTJEN CIVILE

ZJARRET NË PYJE

UDHËZIME PËR SIGURIMIN

LOJA
E KOMANDËS
SË ZJARRFIKSAVE
SVAROG 2017



NË RAST SE GJENDENI NË NATYRË

1. Mos i ndizni plehërat ose barin dhe degët e thata në ambient të hapur gjatë muajve të verës.
2. Mos piqni mish në zgarrë ose hell në ambient të hapur, si në pyll, ashtu edhe në vendet ku ka bar të thatë në afërsi.
3. Mos ndërmerrni veprime që mund të shkaktojnë zjarr (gjithçka që prodhon shkëndija).
4. Mos hidhni në pyll cigare ose mbeturina të ndezura, si dhe xhama. Ekziston rrezik zjarri.
5. Respektoni shënjat e ndalimit të hyrjes gjatë periudhës kur ka rrezik të madh zjarri.

NË RAST SE SHTËPIJA JUAJ GJENDET NË PYLL OSE NË AFËRSI TË TIJ

1. Ndërtoni mur rreth shtëpisë tuaj të paktën 10 metra larg barit, gjetheve, boçeve të pishës dhe degëve të thata.
2. I krasitni pemët në lartësi jo më të vogël se 3 metra në varësi të vjetërsisë dhe gjendjes së tyre.
3. Krasitini degët e thata nga pemët si dhe kaçubet.
4. Mos lejoni që degët e pemëve të prekin muret, çatinë dhe ballkonet e shtëpisë.
5. Pritini degët e pemëve në mënyrë që ato të jenë të paktën 5 metra larg shtëpisë.
6. Krasitini degët e pemëve në mënyrë që të jenë të paktën 3 metra larg njëra-tjetrës. Për siguri më të madhe, pritni të gjitha pemët dhe shkurret që gjenden në distancë 10 metra larg shtëpisë.
7. Mos montoni në muret e shtëpisë ullukë plastike dhe tubacione uji plastike dhe as mos montoni në dyer e dritare roleta prej materialesh që ndizen.
8. Verifikoni nëse kapakët e oxhaqeve dhe të ventilimit të shtëpisë janë prej materialesh që nuk ndizen si dhe të papërshkueshëm nga shkëndijat.
9. Mos depozitoni pranë shtëpisë lëndë që ndizen.
10. Drutë për ngrohje i stivosni në ambjent të mbyllur dhe të mbrojtur.
11. Mos lini enë karburanti të hapura në afërsi të shtëpisë.
12. Blini pajisje të përshtatshme për fikjen e zjarrit dhe i mirëmbani ato.
13. Siguroni zonën që duhet të mbrohet me zorra ujitjeje ose të ngjashme me to, si dhe me zorra dhe pompë e cila mund të punojë pa korrent elektrik.

KUR BIE ZJARR

1. Njoftoni menjëherë Qendrën operative për komunikim të Drejtorisë së Emergjencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme në numrin 112 ose Shërbimin Bashkiak të mbrojtjes dhe shpëtimit në numrin 123.
2. Jepni informacione sa më të sakta për:
 - Vendndodhjen e saktë ku gjendeni;
 - Zonën ku po përhapet zjarri;
 - Llojin e vegjetacionit ku ka rënë zjarri.



NË RAST SE ZJARRI I AFROHET SHTËPISË TUAJ

1. Mos krijoni panik.
2. Futini të gjitha lëndët që ndizen, që ndodhen pranë shtëpisë tuaj, në ambiente të mbyllura e të siguruar.
3. Mbyllni të gjitha vendet e hapura (oxhaqet, dritaret, dyert etj.), në mënyrë që hiri i nxehët të mos ketë mundësi që të futet në shtëpi.
4. Stakoni tubacionin e gazit dhe/ose të karburantit brenda dhe jashtë shtëpisë.
5. Hiqni tendat nga ballkonet dhe dritaret.
6. Mundësoni qasjen e mjeteve të zjarriksave dhe të shpëtimit, duke hapur portat.
7. Vendosni shkallë në murin e jashtëm të shtëpisë në drejtim të kundërt me përhapjen e zjarrit në mënyrë që të siguron qasje direkte në çati.
8. Takoni zorrat e ujit në mënyrë që të mbuloni të gjithë sipërfaqjen e shtëpisë.
9. Në rast se është zvogëluar pamshmëria, ndizni dritat brenda e jashtë në mënyrë që të shikoni nëpër tym.

KUR ZJARRI ËSHTË FIKUR

1. Dilni nga shtëpia dhe fikni mbetjet e zjarrit.
2. Verifikoni regullisht herë pas here mbetjet e zjarrit në afërsi të shtëpisë, e kjo të paktën për një periudhë kohore 48 orë.

NË RAST SE ZJARRI GJENDET PRANË SHTËPISË TUAJ

1. Të dilni nga shtëpia vetëm në rastet kur dalja është plotësisht e sigurtë, në të kundërtën qëndroni benda në shtëpi.
2. Mos hipni në makinë. Mundësia e shpëtimit është më e madhe kur jeni në shtëpi e jo në makinë, e kjo për shkak të materialeve të ndezëshme.
3. Në rast se qëndroni në shtëpi:
 - Mbyllni dyert e dritaret;
 - Bllokoni të çarat me leckë të njomura për të penguar hyrjen e tymit;
 - Hiqni perdet e dritareve;
 - Mobiljet që gjenden pranë dritareve vendosini në qendër të dhomës;
 - Mbyllini dyert e brendëshme që të ngadalësoni përhapjen e zjarrit;
 - Mbushni me ujë vaskën, lavamanet dhe kovat;
 - Mbidhuni të gjithë në një dhomë;
 - Verifikoni a keni llampa me bateri si dhe bateri për rastet e ndërprerjes së korrentit.
4. Në rast se shtëpia është prej druri, futuni për siguri në një ndërtesë me mure të zakonshme.
5. Në rast se ju kanë urdhëruar që të evakuoheni, ndiqni me fanatizëm udhëzimet e organeve kompetente si dhe drejtimet e evakuimit.

LOJA
E KOMANDËS
SË ZJARRFIKSAVE
SVAROG 2017

